



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:230279

Datë: 18.09.2024

Numri i dokumentit: 06173832

C.nr.8222/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditësve: 1) S.B - J; 2) H.K; 3) S.N; 4) N.B dhe 5) SH.Ç, të gjithë nga P, të përfaqësuar në bazë të autorizimit (prokurës) nga I.D, avokat me seli në P, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Qendra e Mjekësisë Urgjente, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga A.SH - Zyrtare e lartë ligjore pranë të paditurës, me objekt kontesti kompensimin e pagave shtesë për punë gjatë vikendeve, punës së natës dhe gjatë festave zyrtare, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik, me datë 12.09.2024, në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me datë 18.09.2024, mori dhe të njejtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: 1) S.B - J; 2) H.K; 3) S.N; 4) N.B dhe 5) SH.Ç, të gjithë nga P, ashtu që: DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Qendra e Mjekësisë Urgjente, me seli në Prishtinë, që paditësve, në emër të pagës shtesë për orët e punës gjatë vikendeve, punës gjatë natës dhe gjatë festave zyrtare për periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, t'ua paguajë shumat si në vijim:

- Paditëses S.B - J nga P, në emër të pagave shtesë për periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, shumën prej 8,370.16 €, në emër të kontributit pensional shumën prej 984,72 €, shumë kjo e cila duhet paguar në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe në emër të tatimit në paga, shumën prej 984,72 €, shumë kjo e cila duhet deklaruar pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

- Paditëses H.K nga P, në emër të pagave shtesë për periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, shumën prej 6,139.42 €, në emër të kontributit pensional shumën prej 722,28 €, shumë kjo e cila duhet paguar në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe në emër të tatimit në paga, shumën prej 722,29 €, shumë kjo e cila duhet deklaruar pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

- Paditëses S.N nga P, në emër të pagave shtesë për periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, shumën prej 8,169.13 €, në emër të kontributit pensional shumën prej 961.08 €, shumë kjo e cila duhet paguar në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe në emër të tatimit në paga, shumën prej 961/07 €, shumë kjo e cila duhet deklaruar pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

- Paditësit N.B nga P, në emër të pagave shtesë për periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, shumën prej 4,702.08 €, në emër të kontributit pensional shumën prej 553.18 €, shumë kjo e cila

duhet paguar në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe në emër të tatimit në paga, shumën prej 553.19 €, shumë kjo e cila duhet deklaruar pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

- Padi tëses SH.Ç nga P, në emër të pagave shtesë për periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, shumën prej 5,248.96 €, në emër të kontributit pensional shumën prej 617.52 €, shumë kjo e cila duhet paguar në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe në emër të tatimit në paga, shumën prej 617.52 €, shumë kjo e cila duhet deklaruar pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Qendra e Mjekësisë Urgjente, me seli në Prishtinë, që paditësve 1) S.B - J; 2) H.K; 3) S.N; 4) N.B dhe 5) SH.Ç, të gjithë nga P, shumat e gjuakuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ua paguajë së bashku me normën e kamatës ligjore prej 8 % në vit, e cila do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë në Gjykatë, dt.14.10.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Qendra e Mjekësisë Urgjente, me seli në Prishtinë, që paditësve 1) S.B - J; 2) H.K; 3) S.N; 4) N.B dhe 5) SH.Ç, të gjithë nga P, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ua paguajë shumën e përgjithshme prej 3,270.00 €, dhe atë në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit 1) S.B - J; 2) H.K; 3) S.N; 4) N.B dhe 5) SH.Ç, të gjithë nga P, përmes përfaqësuesit të autorizuar, I.D, avokat me seli në P, pranë kësaj Gjykate me dt.14.10.2021, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Qendra e Mjekësisë Urgjente, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e pagave shtesë. Në referatin e padisë ndër tjera pretendohet se paditësit janë të punësuar pranë të paditurës, ndërsa në bazë të nenit 8 të Kontratave të punës është përcaktuar e drejta në paga shtesë, në përqindje të pagës bazë dhe atë: 20 % në orë për kujdestari; 30 % në orë për punë gjatë natës; 30 % në orë për punë jashtë orarit; 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave dhe 50 % në orë për punë gjatë fundjavës. Tutje pretendohet se paditësit, për shkak të natyrës së punës së tyre, në përputhje me detyrat e punës sipas kontratës, kryejnë punë gjatë natës, punë jashtë orarit dhe punë gjatë ditëve të festave zyrtare. E paditura, përkundër faktit që në bazë të kontratës së punës është e detyruar që paditësve t'ua kompensojë pagat shtesë, në përqindje të pagës bazë për orët e punës gjatë natës, jashtë orarit dhe gjatë ditëve të festave, nuk e ka bërë pagesën në lartësi dhe përqindje sipas kontratave të punës. Mbi këtë bazë, i kanë propozuar Gjykatës që të caktojë shqyrtim gjyqësor, të administrojë provat e propozuara dhe pas administrimit të provave në mbështetje të dispozitës së nenit 245 dhe 288 të LMD-së të merr aktgjykim, me të cilin aprovohet në tërësi kërkesëpadija e paditësve.

Në seancë përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, paditësit, përmes përfaqësuesit të autorizuar ndër tjera kanë deklaruar se mbeten në tërësi pranë padisë, duke propozuar që të obligohet e paditura që brenda një afati të arsyeshëm kohor t'i prezantojë për Gjykatën dhe palën kundërshtare listat e paditësve për punë gjatë natës, gjatë festave dhe jashtë orarit. Me qëllim të vërtetimit të lartësisë së kërkesëpadiës, respektivisht pagave shtesë për paditësit ka propozuar

nxjerrjen e provës përmes ekspertizës nga lëmia financiare, me detyrë që në bazë të kontratave të punës, listave të pagave, punës gjatë natës, festave zyrtare dhe punës jashtë orarit për periudhën kohore 19.10.2018 deri me datë 31.01.2023, të konstatojë për secilin paditës lartësinë e pagave shtesë për këto kategori. Me rastin e pranimit të ekspertizës financiare, respektivisht sqarimeve të dhëna nga eksperti përkatës në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.12.09.2024, përfaqësuesi i autorizuar i paditësve ka theksuar se nuk ka vërejtje ndaj të njejtës. Përmes parashtrësës së deponuar në Gjykatë me dt.20.08.2024, është bërë ndryshimi i kërkesëpadsisë, duke i propozuar Gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadsia dhe të detyrohet e paditura që paditësve, në emër të pagës shtesë për orët e punës gjatë vikendeve, punës gjatë natës dhe gjatë festave zyrtare për periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, t'ua paguajë shumat e specifikuar si në petitum të kërkesëpadsisë, respektivisht dispozitiv të këtij aktgjykimi, të gjitha me normën e kamatës ligjore prej 8 % në vit, e cila do të llogaritet nga data e ushtrimit të padsisë, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në formë të specifikuar në fjalë përfundimtare dhe atë: për përpilim të padsisë shumë prej 624,00 €; për taksë gjyqësore për padi shumë prej 100.00 €; për ekspertizë financiare shumë prej 300.00 €; për dy seanca të mbajtura shumë prej nga 811.00 €, apo shumë prej 1,622.00 €, për precizim të kërkesëpadsisë shumë prej 624.00 €, apo shumë e përgjithshme prej 3,270.00 €.

E paditura si përmes përgjigjes në padi, të deponuar në Gjykatë me dt.20.01.2023, ashtu edhe në seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, fillimisht mbi bazën e pretendimit se paditësit nuk kanë ofruar prova që i kanë shterur të gjitha mjetet juridike para se t'i drejtohen Gjykatës me padi, ashtu siç është e paraparë me nenin 78 par.1 të Ligjit të Punës. Më tej pretendohet se në rastin konkret ekziston edhe parashkrimi i kërkesës, me arsyetim se kërkesat e tilla nga marrdhënia e punës parashkruhen brenda afatit 3 vjeçar. Tutje pretendohet se kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, e po ashtu theksohet se e paditura gjatë përgaditjes së buxhetit nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për këto forma të kompensimit. Në raport me propozimin për nxjerrjen e provës përmes ekspertizës financiare, nuk e ka kundërshtuar një propozim të tillë në aspektin procedural, ndërsa me rastin e pranimit të ekspertizës, gjegjësisht dhënies së sqarimeve plotësuese nga eksperti përkatës në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se nuk ka vërejtje ndaj të njejtës. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që kërkesëpadsia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pa bazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.12.09.2024, gjatë procedurës së administrimit të provave, ka administruar provat materiale si në vijim: Kontratat e punës për paditësit 1) S.B - J; 2) H.K; 3) S.N; 4) N.B dhe 5) SH.Ç; Listat e pagave për paditësit; Listat e orëve për punë gjatë vikendeve, ndërrimin e natës dhe gjatë festave zyrtare për periudhën kohore tetor 2018 - janar 2023; Ekspertiza financiare e përpiluar nga ekspertja A.S-P me dt.28.05.2024, së bashku me sqarimet plotësuese të dhëna në seancën e shqyrtimit kryesor.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, me ç'rast ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga provat e administruara, Gjykatës i rezulton se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti që paditësit janë në marrëdhënie të rregullt pune pranë të paditurës dhe atë: Paditësja S.B - J, e sistemuar në vendin e punës “Mjek Specialist” në Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë; Paditësja H.K, e sistemuar në vendin e punës “Infermiere – Vozitëse” në Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë; Paditësja S.N, e sistemuar në vendin e punës “Specialist i Mjekësisë Familjare” në Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë; Paditësi N.B, i sistemuar në vendin e punës “Vozitës” në Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë; Paditësja SH.Ç, e sistemuar në vendin e punës “Mjek Specialist” në Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë.

Në raport me bazën ligjore të mbështetjes së kërkesëpadisë, duke marrë për bazë natyrën e kontestit, raportin juridik mes palëve ndërgjyqëse, si dhe kohën kur është krijuar ky raport, duhet t'i referohemi dispozitave të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.11.2010, ligj ky i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit. Dispozita nga neni 1, e cila i referohet qëllimit të këtij ligji përcakton që: *“Ky ligj ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhëniet e punës, siç përcaktohen me këtë ligj”*. Në anën tjetër, dispozita nga neni 2, e cila i referohet fushës së zbatimit, përcakton: *“Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës”*. Dispozita nga neni 56, e cila normon çështjen e të drejtës në pagë shtesë, në paragrafin 1 përcakton që: *“Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuarit ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës”*. Paragrafi 2 i të njejtës dispozite përcakton që: *“Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë: 20 % në orë për kujdestari; 30 % në orë për punë gjatë natës; 30 % në orë për punë jashtë orarit; 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës”*. Së fundmi, paragrafi 3 përcakton: *“Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit e përjashtojnë njëra - tjetrën.”*

Sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësve, është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizës financiare, me ç'rast për ekspert është caktuar A.S-P. Ekspertja e lartëcekur ka pasur për detyrë që mbi bazën e njohurive profesionale, në bazë të kontratave të punës, listave të pagave, punës gjatë natës, festave zyrtare dhe punës jashtë orarit për periudhën kohore 19.10.2018 deri me datë 31.01.2023, të konstatojë për secilin paditës lartësinë e pagave shtesë për këto kategori.

Ekspertja përkatëse ka përpiluar mendimin me shkrim me datë 28.05.2024, me ç'rast ka dhënë këto konstatime:

Paditësja S.B, përgjatë periudhës kohore 19.10.2018 - 31.12.2018, ka pasur 85 orë të punës gjatë vikendeve, 75 orë të punës gjatë natës, 8 orë të punës gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2019 paditësja ka pasur 405 orë të punës gjatë vikendeve, 360 orë të punës gjatë natës, 55 orë të punës gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2020 ka pasur 393 orë të punës gjatë vikendeve, 350 orë pune gjatë natës, 60 orë pune gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2021 ka pasur 387 orë pune gjatë vikendeve, 370 orë pune gjatë natës, 80 orë pune gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2022 ka pasur 412 orë pune gjatë vikendeve, 360 orë pune gjatë natës, 65 orë pune gjatë festave; Gjatë muajit janar

të vitit 2023 ka pasur gjithsejt 43 orë pune gjatë vikendeve, 34 orë pune të natës dhe 16 orë pune gjatë festave.

Paditësja H.K, përgjatë periudhës kohore 19.10.2018 - 31.12.2018, ka pasur 80 orë të punës gjatë vikendeve, 78 orë të punës gjatë natës; 11 orë të punës gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2019 paditësja ka pasur 412 orë të punës gjatë vikendeve, 340 orë të punës gjatë natës, 70 orë të punës gjatë festave, Gjatë vitit kalendarik 2020 ka pasur 393 orë të punës gjatë vikendeve, 370 orë pune gjatë natës, 75 orë pune gjatë festave,; Gjatë vitit kalendarik 2021 ka pasur 387 orë pune gjatë vikendeve, 360 orë pune gjatë natës, 65 orë pune gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2022 ka pasur 405 orë pune gjatë vikendeve, 350 orë pune gjatë natës, 60 orë pune gjatë festave, Gjatë muajit janar të vitit 2023 ka pasur gjithsejt 48 orë pune gjatë vikendeve, 32 orë pune të natës dhe 18 orë pune gjatë festave.

Paditësja S.N, përgjatë periudhës kohore 19.10.2018 - 31.12.2018, ka pasur 82 orë të punës gjatë vikendeve, 75 orë të punës gjatë natës, 5 orë të punës gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2019 paditësja ka pasur 412 orë të punës gjatë vikendeve, 350 orë të punës gjatë natës, 60 orë të punës gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2020 ka pasur 405 orë të punës gjatë vikendeve, 350 orë pune gjatë natës, 55 orë pune gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2021 ka pasur 387 orë pune gjatë vikendeve, 360 orë pune gjatë natës, 65 orë pune gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2022 ka pasur 405 orë pune gjatë vikendeve, 360 orë pune gjatë natës, 65 orë pune gjatë festave; Gjatë muajit janar të vitit 2023 ka pasur gjithsejt 48 orë pune gjatë vikendeve, 32 orë pune të natës dhe 13 orë pune gjatë festave, gjithsejt 91 orë pune shtesë.

Paditësi N.B, përgjatë periudhës kohore 19.10.2018 - 31.12.2018, ka pasur 85 orë të punës gjatë vikendeve, 78 orë të punës gjatë natës, 8 orë të punës gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2019 paditësja ka pasur 398 orë të punës gjatë vikendeve, 320 orë të punës gjatë natës, 80 orë të punës gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2020 ka pasur 398 orë të punës gjatë vikendeve, 360 orë pune gjatë natës, 75 orë pune gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2021 ka pasur 398 orë pune gjatë vikendeve, 370 orë pune gjatë natës, 55 orë pune gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2022 ka pasur 420 orë pune gjatë vikendeve, 350 orë pune gjatë natës, 60 orë pune gjatë festave, Gjatë muajit janar të vitit 2023 ka pasur gjithsejt 40 orë pune gjatë vikendeve, 38 orë pune të natës dhe 19 orë pune gjatë festave.

Paditësja SH.Ç, përgjatë periudhës kohore 19.10.2018 - 31.12.2018, ka pasur 0 orë të punës gjatë vikendeve, 0 orë të punës gjatë natës, 0 orë të punës gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2019 paditësja ka pasur 412 orë të punës gjatë vikendeve, 374 orë të punës gjatë natës, 75 orë të punës gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2020 ka pasur 405 orë të punës gjatë vikendeve, 369 orë pune gjatë natës, 65 orë pune gjatë festave,; Gjatë vitit kalendarik 2021 ka pasur 387 orë pune gjatë vikendeve, 81 orë pune gjatë natës, 55 orë pune gjatë festave; Gjatë vitit kalendarik 2022 ka pasur 405 orë pune gjatë vikendeve, 0 orë pune gjatë natës, 75 orë pune gjatë festave; Gjatë muajit janar të vitit 2023 ka pasur gjithsejt 0 orë pune gjatë vikendeve, 0 orë pune të natës dhe 0 orë pune gjatë festave.

Si përfundim, ekspertja ka konstatuar se e paditura u detyrohet paditësve shumë si në vijim: Paditëses S.B - J nga P, në emër të pagave shtesë për periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, shumë prej 8,370.16 €, në emër të kontributit pensional shumë prej 984,72 €, shumë kjo e cila

duhet paguar në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe në emër të tatimit në paga, shumën prej 984,72 €, shumë kjo e cila duhet deklaruar pranë Administratës Tatimore të Kosovës; Padi tëses H.K nga P, në emër të pagave shtesë për periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, shumën prej 6,139.42 €, në emër të kontributit pensional shumën prej 722,28 €, shumë kjo e cila duhet paguar në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe në emër të tatimit në paga, shumën prej 722,29 €, shumë kjo e cila duhet deklaruar pranë Administratës Tatimore të Kosovës; Padi tëses S.N nga P, në emër të pagave shtesë për periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, shumën prej 8,169.13 €, në emër të kontributit pensional shumën prej 961.08 €, shumë kjo e cila duhet paguar në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe në emër të tatimit në paga, shumën prej 961/07 €, shumë kjo e cila duhet deklaruar pranë Administratës Tatimore të Kosovës; Padi tësit N.B nga P, në emër të pagave shtesë për periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, shumën prej 4,702.08 €, në emër të kontributit pensional shumën prej 553.18 €, shumë kjo e cila duhet paguar në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe në emër të tatimit në paga, shumën prej 553.19 €, shumë kjo e cila duhet deklaruar pranë Administratës Tatimore të Kosovës; Padi tëses SH.Ç nga P, në emër të pagave shtesë për periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, shumën prej 5,248.96 €, në emër të kontributit pensional shumën prej 617.52 €, shumë kjo e cila duhet paguar në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe në emër të tatimit në paga, shumën prej 617.52 €, shumë kjo e cila duhet deklaruar pranë Administratës Tatimore të Kosovës;

Në kuptim të dispozitës nga neni 362 par.1 të LPK-së, ekspertja financiare ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor për të dhënë sqarimet plotësuese, me ç'rast ka deklaruar se qëndron pranë ekspertizës së punuar dhe sqaron se gjatë konsultave të zyrtarja përgjegjëse në kuadër të Qendrës së Mjekësisë Urgjente në Prishtinë ka pyetur se çka përfshihet në kujdestari dhe a mund të ndodhë që brenda kujdestarisë të ketë orë të vikendeve, orë të punës gjatë natës dhe gjatë festave zyrtare dhe i është kthyer përgjigja që mund të ketë të tilla, andaj i ka zbritur nga përlllogaritjet.

Në këtë mënyrë, në raport me lartësinë e kërkesëpadi së, Gjykata iu referua pikërisht të gjeturave nga ekspertiza financiare e lartëcekur, të cilës ekspertizë Gjykata ia fali besimin e plotë, bazuar në faktin se e njejta është përpiluar në mënyrë profesionale, mbi bazën e të gjithë parametrave dhe standardeve të kërkuara. Për më tepër, të gjeturat e kësaj ekspertize nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet tjera të ngritura nga ana e të paditurës përmes përgjigjes në padi, ashtu edhe në seancën e shqyrtimit kryesor, të cilat përqendrohen në disa rrethana:

Sa i përket pretendimit se padi tësit nuk kanë ofruar prova se i kanë shterur të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative para se t'i drejtohen Gjykatës me padi, siç është paraparë me dispozitën nga neni 78 par.1 të Ligjit të Punës, Gjykata vlerëson se lidhur me realizimin e kërkesave të tilla të cilat kanë karakter monetar, nuk është e domosdoshme që i punësuar i t'i shfrytëzojë të drejtat e përcaktuara nga dispozitat e lartëcekura pranë punëdhënësit, pra nuk ka ndonjë pengesë që t'i drejtohet Gjykatës drejtpërdrejtë përmes ushtrimit të padisë.

Në raport me pretendimin e ngritur nga e paditura lidhur me parashkrimin e kërkesës, një pretendim të tillë Gjykata po ashtu e vlerëson të pa themeltë, mbi bazën e këtyre arsyeve: Kërkesa për kompensimin e e pagave shtesë për secilin prej padi tësve përfshin periudhën kohore 19.10.2018 - 31.01.2023, ndërsa padia është ushtruar në Gjykatë me datë 14.10.2021. Dispozita nga neni 87 e

Ligjit të Punës përcakton: "*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*". Në anën tjetër, dispozita nga neni 369 e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve sqaron se ndërprerja e parashkrimit vjen në shprehje me rastin e paraqitjes së padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës. Në rastin konkret, kemi të bëjmë me kërkesa periodike, me ç'rast e drejta për paraqitjen e kërkesës për një kompensim të tillë për secilin paditës ka filluar të rrjedhë nga muaji tetor i vitit 2018, kur është bërë e arritshme kërkesa e parë, duke vazhduar të rrjedhë për çdo muaj vijues deri në ditën kur është bërë e arritshme kërkesa e fundit, në muajin janar të vitit 2023. Meqenëse nga koha kur është bërë e arritshme kërkesa e parë (tetor 2018), e deri në momentin e paraqitjes së padisë (14.10.2021) nuk ka kaluar afati i përcaktuar prej 3 (tre) vitesh, rezulton se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës.

Lidhur me pretendimin se kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, Gjykata vlerëson se e drejta e paditësve për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës, buron pikërisht nga dispozitat e këtij ligji, në mënyrë specifike nenit 56 të të njejtit, i cili është cituar në pjesën e mësipërme të arsytimit të këtij aktgjykimi. Pretendimin lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tilla, Gjykata po ashtu e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një rrethanë e tillë nuk mund të konsiderohet pengesë që paditësit t'i realizojnë të drejtat e garantuara me dispozitat e ligjit bazik i cili normon të drejtat nga marrëdhënia e punës, të cilat janë të karakterit obligativ, nënkuptohet mbi bazën e plotësimit të kushteve të përcaktuara. Në këtë mënyrë, pretendimet e ngritura nga ana e të paditurës, Gjykata i vlerësoi pa ndikim në krijimin e një bindje tjetër në raport me vendosjen e kësaj çështje.

Gjykata në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi edhe lidhur me kërkesën aksesore, duke e detyruar të paditurën që shumat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ua paguajë paditësve së bashku me kamatën ligjore prej 8 % në vit, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Një vendosje e tillë gjen mbështetje në dispozitën nga neni 382 të LMD-së, e cila parasheh që: "*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*". Me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata, Gjykata iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020, konkretisht pjesës së tretë, pikës XIV të këtij Mendimi.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, nga pika III e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 par.1, 454 par.1 lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurën që paditësve si palë gjyqfituese t'ua kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve të domosdoshme në këtë procedurë në vlerë të përgjithshme prej 3,270.00 Euro, sipas kërkesës së specifikuar në fjalë përfundimtare, dhe atë: 624.00 Euro për përpilim të padisë; 1,622.00 Euro për prezantim në dy seanca gjyqësore (nga 811.00 Euro për secilën seancë), 100.00 Euro në emër të taksës gjyqësore për padi, 300.00 Euro në emër të ekspertizës financiare dhe 624.00 Euro në emër të përpilimit të parashtrësës për precizim të padisë. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të aprovuara, Gjykata iu referua Rregullores mbi Tarifat e Avokatëve (numrave tariforë 6 dhe 7), duke marrë në referencë edhe vlerën e kontestit.

Numri i lëndës: 2021:230279
Datë: 18.09.2024
Numri i dokumentit: 06173832

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 142, lidhur me nenin 160 të LPK-së, u vendos decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL -
C.nr.8222/21, datë 18.09.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.